



I nderuar përdorues,

Ju keni hyrë në faqen zyrtare të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A., duke lexuar dhe pranuar si më poshtë sa vijon:

Kjo përmban formularë të ndryshëm (punësimi, regjistrimi në databazën e SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A., raportim dëmi, blerje online etj.) plotësimi i të cilave është tërësisht vullnetar.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. siguron të gjithë përdoruesit e kësaj faqeje se çdo e dhënë personale do të trajtohet në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082, datë 30.01.2019 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Përdoruesi pohon vërtetësinë dhe saktësinë e të gjitha të dhënave të plotësuara prej tij në format apo formularët e ndryshëm. Me plotësimin e çdo forme apo formulari dhe shtypjen e butonit të vazhdimit, përdoruesi pranon të drejtën e shoqërisë së sigurimit për përdorimin e brendshëm vetëm për qëllimin e kërkuar nga përdoruesi të informacioneve të plotësuara si dhe procesimin e mëtejshëm të tyre nga ana e SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A.. SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. garanton trajtimin me konfidencialitet të këtyre të dhënave si dhe siguron se asnjë e dhënë nuk do tu kalohet palëve të treta por çdo e dhënë do të përdoret vetëm për qëllimin që është dërguar. Për çdo ndryshim të këtyre të dhënave përdoruesi ka të drejtë të kontaktojë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. për kryerjen e ndryshimeve në personaldata@uniqa-ks.com

PARIMET E PRIVATËSISË TË TË SIGURUARIT DHE PËRFITUESIT

1. Mbledhja e informacionit: SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. do të mbledhë vetëm informacionin personal i cili nevojitet për administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënien e shërbimeve të klientit, për trajtimin e dëmeve të raportuara nga klienti, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në ligjet përkatëse në fuqi (Ligji Nr. 06/L-082, datë 30.01.2019, "Për mbrojtjen e të dhënave personale").
2. Përpunimi i informacionit: SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. do të përpunojë të dhënat tuaja personale në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dhe vetëm për ato qëllime që ju ka informuar në momentin e nënshkrimit të kontratës së sigurimit. Ju mund të kundërshtoni për disa lloje të përpunimit të të dhënave shprehimisht të lejuara me Ligjin Nr. 06/L-082, datë 30.01.2019 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
3. Mundësia e zgjedhjes: SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. ju jep mundësinë e autorizimit të përdorimit të të dhënave personale për qëllime marketingu, p.sh., informim rreth produkteve dhe shërbimeve të reja të ofruara nga SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. ose palë të treta që veprojnë në emër të saj sipas ligjit në fuqi. Kjo përfshin produkte dhe shërbime nga SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. dhe produkte dhe shërbime të bëra në bashkëpunim me partnerë të tjerë biznesi.
4. Cilësia e përpunimit të të dhënave: SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. përdorë teknologji të përshtatshme dhe trajnon punonjësit e vet me njohuri të mjaftueshme teknike dhe gjithashtu siguron integritet personal që ata të jenë të aftë të përpunojnë të dhënat tuaja me shpejtësi dhe saktësi bazuar në ligjet në fuqi. SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. nuk do të mbajë të dhënat tuaja personale më shumë se sa është e nevojshme, për rasteve që parashikohet ndryshe nga ligjet në fuqi.



5. Siguria dhe fshehtësia: SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. do të mbajë të dhënat tuaja personale konfidenciale dhe do të kufizojë aksesin në të dhënat tuaja vetëm për qëllime të sigurimit. SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. i referohet standardeve të industrisë dhe përdorë masa të arsyeshme administrative, teknike dhe fizike të sigurisë për të mbrojtur të dhënat tuaja personale nga akses i paautorizuar, përdorimi, shkatërrimi dhe modifikimi apo zbulimi i tyre. SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. kërkon standarde të larta të sigurisë së të dhënave nga palët e treta të cilat ajo i autorizon për të përpunuar të dhënat tuaja personale në emër të saj.
6. Shpërndarja e të dhënave: SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. mund të transferojë të dhënat tuaja personale me palë të treta të cilat veprojnë në emër të saj dhe nën udhëzimet e saj për informimin tuaj për produkte dhe shërbime dhe vetëm pasi ka marrë aprovimin tuaj paraprakisht.
7. Transferimi ndërkombëtar: SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. mund të transferojë jashtë shteti për qëllime të sigurimit dhe dëmshpërblimit në sigurime të dhënat të cilat transferohen vetëm në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082, datë 30.01.2019 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Pavarësisht nëse të dhënat tuaja transferohen ose jo jashtë shtetit, ato mbrohen nga parimet e përmendura në këtë dokument.
8. Përgjegjësia: SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. dhe punonjësit e saj mund të përpunojnë të dhënat personale në pajtim me këto parime dhe ligjin e zbatueshëm. SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. kryen trajnime dhe rishikime të pajtueshmërisë së saj me këto parime. Punonjësit që shkelin këto parime mund të jenë subjekt i masave disiplinore, duke përfshirë pushimin nga puna. Punonjësit pritët të raportojnë shkeljen e këtyre parimeve tek drejtuesit e tyre si dhe tek burimet njerëzore, pranë departamentit ligjor dhe pranë çdo departamenti tjetër kompetent. Ju mund të zbatoni këto parime kundrejt SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. e cila është përgjegjëse për të dhënat tuaja personale. Nëse keni një ankesë që SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. ka shkelur këto parime dhe nëse keni tentuar me mirëbesim për të zgjidhur ankesën përmes procesit të shërbimit tonë të konsumatorëve ose procesit të ankesave sipas Ligjit Nr. 06/L-082, datë 30.01.2019 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", por ankesa juaj nuk është zgjidhur brenda intervalit kohor të parashikuar atëherë ju mund të zbatoni këto parime në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë. Nëse ju ankoheni pranë autoritetit të mbrojtjes së të dhënave (Agjencia për Informim dhe Privatësi) dhe ky autoritet zbulon se SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. ka shkelur këto parime, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. do t'i përmbahet përfundimeve të autoritetit për mbrojtjen e të dhënave por do të rezervojë të drejtën ligjore për të kundërshtuar apo apeluar të tilla gjetje.